

## AKTI THEMELIMIT

### I

#### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR SHPK ORTAK I VETEM "NELSA".

Sot me date " 31.1.1996,une Nexhmi Balla i biri Veliut,lindur ne vitin 1955,me banim ne F.Qesarake te rrethit te Tiranes,per te zhvilluar aktivitet privat,krijoj shoqerine tregtare me ane te ketij akti themelimi,me atributet e ortakut te vetem te saja,e cila duke u mbeshtetur dhe ne ligjin mbi shoqerite tregtare ka keto karakteristika te vecanta te saja.

#### EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria e krijuar prej meje do te quhet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar,SHPK, Ortak i Vetem,"NELSA".

#### Baza ligjore

Kjo shoqeri e krijuar prej meje mbeshtetet ne dispozitat ligjore qe parashikon ligji "Per shoqrite Tregtare",si dhe ligjet e tjera qe mbrojne aktivitetin privat dhe cdo lloj tjeter qe rregullon veprimtarine e shoqerive tregtare.

#### OBJEKTI I AKTIVITETIT

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saja, "Prodhim brumerash si buke, dhe artikuj te tjere te kesaj natyre,import eksport dhe tregtimi me shumice i dritherave te bukes,si grure,miser,etj.I artikujve industriale dhe ushqimore,blektorale dhe bujqesore,i prodhimeve meterluggjike,si tuba,llamarine,transport mallrash,i materjaleve te nderti mit dhe transport udhetaresh.

#### AFATI I VEPRIMTARISE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saja ne nje periudhe mbi 10 vjet.Ajo mund te nderpresu aktivitetin e saja dhe parakohe,sipas mundesive financiare ose kur ka shka qe ligjore per te nderprere aktivitetin e kesaj shoqerie.

#### SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saja ne F.Qesarake te rrethit te Tiranes,ne shtepine e ortakut te vetem.

#### KAPITALI THEMELORE

Kapitali themelore i shoqerise eshte 100.000 leke e derdhur prej ortakut te vetem ne nje nga bankat e Shqiperise.



DREJTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te drejtohet prej asamblese se ortakeve kur te te mund te kete me shume se nje ortak. Aktualisht duke qene shoqeri me ortak te vetem, ajo do te drejtohet prej ortakut te vetem Nexhmi Balla. Vendimet e ortakut te vetem jane te detyrueshme per tu zbatuar nga cdo drejtues tjetër dhe punonjes qe eshte i punesuar ne kete shoqeri.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te administrohet prej administratorit qe ne kete shoqeri administratori i saja eshte ortaku i vetem Nexhmi Balla. Me deshiren time dhe me pelqimin tim kete detyre mund tja caktoj nje tjetri duke u emeruar prej meje.

VEPRIMTARIA FINANCIARE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saja per qellime fitimi duke u mbeshtetur ne ekonomine e tregut te lire si dhe mbi ligjet e shtetit per detyrimet e shoqerise ndqj shlyerjes se taksave dhe detyrimeve te tjera financiare. Per efekt te bilancit financiar si rregull viti financiare fillon me date 1 te muajit janar te vitit dhe mbaron me date 31 te muajit dhjetor te vitit.

JURIDIKSIONI I VEPRIMTARISE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saja ne Tirane, dhe ne rrethet te tjera te Shqiperise. Ajo mund te hapi filiale te saja dhe jashte shtetit. Shoqerite e krijuara prej saja si filiale te saja do te quhen shoqeri bija.

ZGJIDHJA E MOSMAREVESHJEVE SHPERBERJA E SHOQERISE


Te gjitha mosmareveshjet me te tretet do te zgjidhen me mirekputim, ne rast se nuk arrihet nje gje e tille, atehere ato do te zgjidhen ne hje gjykata Shqiptare.

Shoqeria mund te shperbshet me mbarimin e afatit ose me pare sipas mundesive financiare, ose kur ka shkaqe ligjore duke u detyar me vendim te gjykates. Shperberja e shoqerise kur nuk ka ndonje detyrim ligjore, behet vetem me vendim te ortakut te vetem.

Persa nuk eshte shprehur ne kete akt themelimi, me hollesisht mbi veprimtarine e shoqerise dhe detyrimet ligjore jane te shprehura me mife ne statutin e saja.

T H E M E L U E S I  
ORTAK I VETEM E ADMINISTRATOR

NEXHMI BALLA.



# S T A T U T

## I

### SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR SHPK ORTAK I VETËM NELSA

Bazuar në aktin e themelimit datë 31.1.1996 të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar SHPK Ortak i vetëm NELSA dhe në zbatim të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992, unë Nexhmi Balla si ortak i vetëm i saj përpiloj statutin e kësaj shoqërie.

#### Dispozita të përgjithshme

Shoqëria ka karakter prodhues dhe tregtar. Ajo do të zhvillojë aktivitetin e saj në kuadrin e ekonomisë së tregut, të konkurrencës së lirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe korrekte ndaj detyrimeve tatimore e financiare.

#### Selia e shoqërisë

##### Neni 1

Selia e shoqërisë do të jetë në fshatin Qesarake të rrethit Tiranë. Shoqëria mund të hapë filiale brenda Shqipërisë dhe jashtë saj. Filialet e kësaj shoqërie do të quhen shoqëri filia.

#### Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë.

##### Neni 2

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është mbi 10 vjet. Shoqëria mund të shpërbëhet para këtij afati me vendim të ortakut të vetëm, ose kur merret një vendim gjyqësor për prishjen e saj.

#### Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

##### Neni 3

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj, "prodhim brumrash si bukë dhe artikuj të tjerë të kësaj natyre, import-eksport dhe tregtimi me shumicë i drithërave të bukës, si grurë, misër etj., i artikujve industrialë dhe ushqimorë, blegtoralë e bujqësore, prodhimeve metalsurgjike, si tuba, llamarinë, transport mallrash i materialeve të ndërtimit dhe transport udhëtarësh.

#### Kapitali i shoqërisë

##### Neni 4

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100 000 lekë i derdhur në Bankën Tregtare në Tiranë prej ortakut të vetëm.

./.  
*Nexhmi Balla*

## Neni 5

Ky kapital mund të shtohet po prej ortakut të vetëm. Kapitale e shoqërisë mund të jenë të transferueshme në një bankë tjetër jashtë Shqipërisë, ashtu dhe çdo përfitim financiar që rrjedh nga aktiviteti i shoqërisë. Ndarja e kapitalit ose këlmi i tij tek të tjerët bëhet me vendim të ortakut të vetëm ose me vendim të një Gjykate.

Drejtimi dhe Administrimi

## Neni 6

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj pasi të jetë regjistruar si person juridik në gjykatën e rrethit Tiranë dhe të ketë siguruar lejet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë. Në gjithë aktivitetin e saj ajo i përmbahet ligjit shqiptar dhe atij ndërkombëtar të pranuar.

## Neni 7

Shoqëria drejtohet nga ortaku i vetëm që merr vendime në përputhje me qëllimin e aktivitetit të shoqërisë. Vendimet e ortakut të vetëm janë të detyrueshme, për t'u zbatuar si nga ndihmësit e tij dhe nga punonjësit.

## Neni 8

Ortaku i vetëm me pëlqimin e tij mund të emërojë një administrator për administrimin e aktivitetit të shoqërisë. Aktualisht administratori i shoqërisë është ortaku i vetëm.

## Neni 9

Kur të ketë administrator, ai është përfaqësuesi ligjor në marrëdhëniet me të tretët dhe me organet kompetente të shtetit shqiptar. Ai kryen veprimtari financiare dhe bankare duke patur të drejtë e firmës në operacionet financiare në llogarinë bankare të shoqërisë.

## Neni 10

Ortaku i vetëm drejton vetë aktivitetin e shoqërisë. Kur ai nuk ndodhet, mund t'i delegojë kompetencat një personi tjetër me anën e një prokure.

## Neni 11

Ortaku i vetëm shqyrton aktivitetin e shoqërisë çdo 3 muaj ose për këtë ai shqyrton raportet e paraqitura nga administratori i

shoqërisë. Ato mund të jenë raporte financiare apo teknike. Ai bën miratimin e tyre ose jo dhe bën vërejtjet përkatëse dhe lë detyra.

#### Marrëdhëniet e punës

##### Neni 12

Të gjithë të punësuarit të cilët merren në punë nga ortakut i vetëm, ose administratori lidhin kontratë për kushtet e punës dhe për mënyrën e pagesës. Në rastin konkret, marrëveshja duhet të jetë në përputhje me legjislacionin e punës në Republikën e Shqipërisë. Të punësuarit janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës e aktivitetit financiar të saj.

#### Bilancet dhe të ardhurat

##### Neni 13

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë mbylLEN më 31 dhjetor të çdo viti, përveç urdhërave të veçanta që administratori i shoqërisë jep për këtë qëllim. Në fund të periudhave mujore dhe tremujore bëhen bilancet e kontabilitetit. Bilanci kontabël i shoqërisë miratohet dhe nënshkruhet nga ortakut i vetëm. Në rast të kundërt ai nënshkruhet nga administratori i shoqërisë kur ka administrator.

##### Neni 14

Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve të akumulimit dhe pagës e detyrimeve fiskale i mbetet ortakut të vetëm. Është e drejtë e ortakut të vendosë për krijimin e fondeve nga të ardhurat neto të krijuara si dhe përdorimi i tyre. Pjesa e fitimit neto që u përket ortakut mund të transferohet lirisht pa kufizim jashtë shtetit shqiptar.

##### Neni 15

Shoqëria ka numrin e saj të llogarisë në Bankën Kombëtare Tregtare. Të drejtën për të kryer veprime bankare e ka ortakut i vetëm ose një person i autorizuar prej tij me prokurë.

#### Shpërndarja e Shoqërisë

##### Neni 16

Shoqëria shpërbëhet kur mbaron afati i veprimitarisë ose pas saj me vendim të ortakut të vetëm ose kur këtë e kërkojnë persona juridikë apo fizikë dhe merret një vendim gjyqësor për këtë qëllim.

*[Signature]*

ose kur vdes ortaku i vetëm dhe trashëgimtarët e tij nuk pranojnë të marrin pjesë në shoqëri.

Dispozita të përgjithshme

Neni 17


Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet çdo ligji të shtetit shqiptar që ka të bëjë me shoqëritë tregtare si ligji "Për shoqëritë tregtare" Nr.7638 datë 19.11.1992.

Neni 18

Ky statut redaktohet në katër kopje, nga të cilat një kopje e mban zyra e Noterisë, një kopje depozitohet në Gjykatën e rrethit Tiranë që bën regjistrimin e Shoqërisë, një kopje në Zyrën e Tatimeve, Tiranë dhe një kopje mbahet nga ortakut i vetëm i shoqërisë.

ORTAKU I VETËM DHE ADMINISTRATOR

NEKHMI BALLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Noteria, TIRANË

Nr. 1103 Kol.  
Nr. 224 Rep.

VËRTETIM

Sot më datë 2.02 1996, para meje Noteres *F. Shehu* u paraqit personalisht Nexhmi BALLA, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi i tij që e mbante me vete, që deklaroi se këtë statut e ka përgatitur jashtë kësaj zyre, e firmos atë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë Noterja pasi bindem se veprimi është bërë sipas ligjit, e miratoj atë, duke e vërtetuar me nënshkrimin tim.

NOTE RE



NOTERE PUBLIKE  
FATMARA SHEHU  
TEL 249 29

